

Dr. Burhan Erkush

TË DREJTAT E NJERIUT

(nga këndvështrimi islam)

Nga turqishtja:

Rehan Neziri

Kreuzlingen, shtator 2024

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
I - Të Drejtat Themelore të Njeriut.....	7
1. E drejta e jetës	8
2. E drejta e lirisë	13
3. E drejta për mbrojtjen e nderit dhe të moralit.....	17
4. Prona dhe e drejta për mbrojtjen e pronës.....	18
5. E drejta për mbrojtje nga tortura.	21
6. E drejta për mbrojtjen e privatësisë	23
7. E drejta për migrim, udhëtim dhe vendbanim	38
8. E drejta për lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes	39
9. E drejta e mendimit dhe e shprehjes së lirë.....	45
10. E drejta për arsim dhe edukim	49
11. E drejta për punë dhe fitim	54
II – Përdorimi dhe Kufizimi i të Drejtave	59
Përmbyllje	62

Hyrje

Feja jonë islame i ka dhënë një vlerë të veçantë njeriut duke e shpallur atë si një qenie të nderuar dhe të lartë (el-Isra, 17:70). I ka dhënë atij të drejtën për të jetuar, për të zgjedhur një fe dhe për të vepruar sipas kërkesave të saj, për të vepruar sipas dëshirës së tij duke i pranuar pasojat, për të zotëruar pasuri, për të udhëtuar, për të mbrojtur shëndetin fizik dhe mendor etj., dhe i ka konsideruar të gjitha këto si të drejta të paprekshme. E ka vlerësuar të qenit njeri si të mjaftueshme për t'i pasur këto të drejta, dhe, në këtë aspekt, nuk ka bërë dallime duke marrë parasysh fenë, gjuhën, racën, gjininë, kombësinë, pasurinë dhe pozitën e personit.

Që nga Ademi a.s., të gjitha fetë qiellore kanë sjellë një mësim të përbashkët ku të drejtat që i përkasin njeriut, të cilat

sot cilësohen si të drejtat themelore të njeriut, janë pranuar si të drejta të fituara që nga lindja vetëm sepse personi është njeri, dhe janë konsideruar si të drejta të patjetërsueshme dhe nga të cilat nuk mund të hiqet dorë. Mbrojtja e këtyre të drejtave ka qenë një nga qëllimet kryesore të feve hyjnore. Përballë sulmeve të padrejta ndaj këtyre të drejtave, janë vendosur sanksione të ndryshme, duke ndryshuar në cilësi dhe sasi, dhe pothuajse çdo sistem ligjor ka bërë rregullime në këtë drejtim gjatë historisë. Megjithatë, duhet theksuar se në botën e sotme, edhe pse këto të drejta teorikisht konsiderohen të paprekshme, në praktikë hasen shumë shembuj të shkeljes së tyre, duke mbetur ato të shkruara vetëm në letër.

Në një kohë kur njerëzit pothuajse klasifikoheshin sipas arsyeve artificiale të epërsisë, si ngjyra, gjuha, raca, fisi dhe prejardhja, konceptin që Islami e solli për njeriun dhe për të drejtat e tij

vazhdon të jetë unik edhe në ditët e sotme. Njeriu i sotëm, i cili që nga lindja është i pajisur me të drejtat që i nevojiten për të jetuar në mënyrë të denjë dhe të nderuar, por që çdo ditë e më shumë po largohet nga thelbi i tij në emër të pasurisë, fuqisë, autoritetit dhe sundimit, po bëhet gjithnjë e më i huaj ndaj vlerave të larta njerëzore dhe po bëhet kërcënim për të tjerët. Tragjeditë njerëzore që po ndodhin në vende të ndryshme të botës, duke nisur nga vendet islame, kanë arritur përmasa të tmerrshme. Pasojat e këtyre tragjedive janë uria, mungesa e ujit, gjaku dhe lotët e derdhur, si dhe fëmijët jetimë të nënçmuar.



Pa dyshim, çdo përpjekje e bërë për t'i shërbyer njeriut dhe për ta mbrojtur dinjitetin e tij, është e shenjtë dhe e vlefshme. Sepse lufta për të drejtat e njeriut, në fakt, është një luftë që ai të mund të jetojë me dinjitet dhe respekt, ashtu siç i ka hije. Fetë hyjnore, kërkimet shkencore dhe ato filozofike gjithmonë e kanë synuar këtë qëllim. Edhe pse është inkurajuese që ekzistojnë përpjekje serioze në fushën e të drejtave të njeriut, është gjithashtu e trishtueshme që këto përpjekje në të vërtetë janë të pamjaftueshme.

Fakti që çështja e të drejtave të njeriut ende qëndron në krye të listës së problemeve të epokës moderne, tregon se njerëzimi ka ende një luftë të gjatë për ta bërë në këtë drejtim.

Edhe ky punim i yni është bërë me qëllim që ta ritheksojë çështjen e të drejtave të njeriut nga perspektiva islame dhe të kontribuojë në përpjekjet që bëhen në këtë fushë.

I - Të Drejtat Themelore të Njeriut

Të drejtat e njeriut në thelb mund t'i ndajmë në dy grupe: të drejtat që i njihen njeriut thjesht sepse është njeri, dhe të drejtat që i jepen për shkak të cilësive që ai ka fituar me anë të përpjekjeve të veçanta. Për shembull, e drejta për jetën është një nga të drejtat që duhet t'i njihet çdo personi, pa marrë parasysh fenë, racën, gjininë apo kombësinë, thjesht nga arsyeja se ai është njeri. Nga ana tjetër, e drejta për të zgjedhur, për t'u zgjedhur apo për të marrë pjesë në disa detyra publike, bën pjesë në grupin e të drejtave ku nuk mjafton vetëm të jesh njeri, por kërkohet që të fitosh disa cilësi me anë të përpjekjeve të veçanta.

1. E drejta e jetës

Në krye të të gjitha të drejtave vjen e drejta e jetës. Çdo qenie e gjallë përpiqet të jetojë dhe natyrshëm i shmang gjërat që mund t'i shkaktojnë dëm. Merr masa për ta mbrojtur veten. Askujt nuk i jepet e drejta për ta vrarë dikë që e ka krijuar Allahu xh.sh. Nuk guxon të vritet një qenie që nuk u shkakton dëm të tjerëve. Sidomos, të vrasësh padrejtësisht një njeri është një krim i madh. Feja jonë e ka konsideruar vrasjen e një tjetri si një nga mëkatet më të mëdha. Kjo për shkak se jeta e njeriut është e shenjtë dhe e paprekshme. Kjo e drejtë nuk mund t'i merret nga askush.

Ajeti në vijim: *"Kush mbytt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit..."* (el-Maideh,

5:32), tregon në mënyrën më të bukur se sa shumë vlerësohet jeta e njeriut në Islam.



Në një ajet tjetër përmenden këto fjalë:
„Dhe mos e mbytni njeriun që Allahu e ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi (që e kërkon e drejta islame). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë)...” (el-Isra, 17:33).

Vrasja e një njeriu është një shkelje e madhe e të drejtës së tij për jetë. E tillë është edhe lëndimi i tij, shkaktimi i vu-

ajtjeve shpirtërore dhe fizike. Po ashtu, vetëvrasja ose shkaktimi i vetëvrasjes nga një person tjetër përbën gjithashtu një shkelje të rëndë të të drejtës për jetë.

Vrasja e padrejtë e një njeriu çon në përhapjen e padrejtësive, sulmeve, vrasjeve dhe konflikteve në shoqëri. Kjo shkakton përçarjen midis njerëzve, përhapjen e gjakmarrjeve dhe prishjen e rendit shoqëror. Nga ana tjetër, mbrojtja dhe shpëtimi i jetës së dikujt mundëson sigurinë e jetës në shoqëri dhe ndihmon që njerëzit të jetojnë në paqe dhe lumturi. Allahu i Madhërisëm e ka konsideruar jetën e një individi po aq të vlefshme sa edhe jetën e gjithë shoqërisë. T'i bësh padrejtësi një individi është njësoj si t'i bësh padrejtësi gjithë shoqërisë.

Të vrasësh fëmijën nga frika e varfërisë, nga frika se nuk e ushqen dot, qoftë duke e braktisur në rrugë, duke e lënë në mëshirë të vdekjes, apo duke e abortuar një fëmijë që tashmë ka zhvi-

lluar gjymtyrët në barkun e nënës, është e ndaluar (*haram*) dhe konsiderohet krim. Allahu i Madhërishëm ka thënë: „*Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, sepse Ne jemi që ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.*” (el-Isra, 17:31).

Në Islam, për ta mbrojtur jetën, në raste shtrëngimi, lejohet kryerja e disa veprimeve që zakonisht janë të ndaluara nga feja, madje në disa raste është e detyrueshme të veprohet kështu. Kjo tregon rëndësinë që i jepet jetës së njeriut, vetë njeriut, në Islam. Për shembull, personit që i ushtrohet dhunë për ta mohuar Allahun, i lejohet ta bëjë këtë vetëm me gojë (en-Nahl, 16:106), ose personit që nuk gjen ushqim tjetër dhe është në rrezik vdekjeje, i lejohet të hajë mish derri ose ushqime të tjera të ndaluara, si cofëtina etj., sa për të mbijetuar (el-Bakara, 2:173). Madje, nëse ai nuk i konsumon këto dhe vdes nga uria, ai

mban përgjegjësi fetare (es-Serahsiu, *el-Mebsut*, Bejrut 1978, XXIV). Këta shembuj tregojnë rëndësinë që i jepet mbrojtjes së jetës.

Ky theksim i rëndësisë së mbrojtjes së jetës, në radhë të parë vjen për shkak se vlerat si feja, mendja, pasuria, familja dhe nderi, bashkohen dhe fitojnë kuptim te një vend i vetëm, te njeriu. Ato kanë rëndësi dhe kuptim vetëm për një person që jeton. Vlerat e përmendura fitojnë rëndësi vetëm në kontekstin e jetës së një njeriu. Feja dhe urdhresat e saj i drejtohen personit që ka jetë, që jeton. Për këto arsye dhe të tjera të ngjashme, Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe të drejtës për jetë.

Sipas fesë sonë, madje edhe në kohë lufte, njerëzit që ikin, që janë të plagosur ose që dorëzohen, nuk guxojnë të vriten. Ata që nuk marrin pjesë në luftë, si gratë, fëmijët, të moshuarit, klerikët, bujqit dhe punëtorët e tjerë që bëjnë punët e tyre, nuk duhen pre-


kur. Kriminelët dhe të burgosurit nuk duhen torturuar, bimët apo prodhimet bujqësore nuk duhet të dëmtohen.

Feja jonë e lartë, ndërkohë që nga njëra anë e thekson se sa e shenjtë është jeta, nga ana tjetër ka si qëllim t'i identifikojë dhe t'i eliminojë të gjitha shkaqet që i çojnë njerëzit drejt krimeve. Duke marrë parasysh periudhën e Profetit Muhammed a.s., mund të përmendim disa nga këto masa: përhapja e ndjenjës së mëshirës dhe e dhembshurisë midis njerëzve, eliminiimi i luftërave dhe i hakmarrjeve midis fiseve, mësimi i shenjtërisë së jetës së vajzave. Këto janë vetëm disa nga masat e ndërmarra për ta mbrojtur jetën.

2. E drejta e lirisë

Në themel të një jete të denjë njerëzore qëndron liria. Çdo njeri lind i lirë dhe jeton i lirë. Liria e njeriut është një e drejtë natyrore që lind bashkë me të. Nuk është e mundur të flitet për lum-

turinë jetësore të një personi që nuk është i lirë. Kur dikujt i merret liria, atij nuk i mbetet më asgjë tjetër në dorë. Skllavëria është gjithashtu një kufizim i lirisë së njeriut.



Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe dinjitetit dhe nderit të njeriut, duke u dhënë të gjithë njerëzve – nga më të moshuarit te më të rinjtë, nga të pasurit te të varfrit, nga të dobët të fuqishmit – një status të lartë si "krijesa më e nderuar" dhe "halif në tokë". Të gjithë njerëzit kanë një status të

barabartë si përballë krijesave, ashtu edhe përballë Krijuesit. Në thelb, skllavërimi i njeriut nga një tjetër njeri është në kundërshtim me frymën dhe thelbin e fesë së *Teuhidit*, që bazohet në parimin se njeriu duhet të jetë rob (shërbyes) vetëm i Allahut xh.sh.

Megjithatë, me keqardhje dihet se që nga epokat parahistorike, njerëzimi ka treguar një prirje të tmerrshme dhe të egër për ta shtypur më të dobëtin, dhe për shkak të kësaj prirjeje të ulët, shumë njerëz janë skllavëruar, duke u përballur me padrejtësi brutale dhe me tortura çnjerëzore.

Padyshim që koncepti i skllavërisë ka hyrë edhe në agjendën e Islamit. Kur u shpall Kur'ani, në të gjitha anët e botës, në lindje dhe perëndim, njerëzit e dobët dhe të pafuqishëm trajtoheshin si mallra që bliheshin dhe shiteshin, pa asnjë të drejtë sociale. Islami nuk mund t'i injoronte këto realitete. Nuk ishte e mundur që skllavëria të eliminohej menjëherë, si me një të prerë

thike, pasi shumë njerëz ishin skllëvër dhe u kishin shërbyer tërë jetën zotërinjve të tyre, duke u shtypur, shfrytëzuar dhe duke u sakrifikuar për ta. Këta njerëz, si qenie njerëzore, kishin të drejta mbi zotërinjtë e tyre, dhe ishte e nevojshme të mbroheshin këto të drejta dhe t'i bëhej e qartë njerëzimit se "edhe skllëvërit janë njerëz". Kjo ishte ajo që e realizoi Islami: i mbrojti të drejtat e skllëvërve. Kur'ani ka rekomanduar që një skllav, i cili dëshiron të fitojë lirinë e tij, të mos pengohet nga zotëria i tij (en-Nur, 24:33). Gjithashtu, ka urdhëruar që një pjesë e të ardhurave të zeqatit të ndahet për lirimin e skllëvërve (et-Teubeh, 9:60). Kur'ani gjithashtu ka caktuar si dëmshpërblim për betimet e thyera, për vrasjet dhe për shkeljen e rregullave të *dhiharit* (një formë e ndalimit të bashkëshortit ndaj bashkëshortes) lirimin e një robi (shih: en-Nisa, 4:92; el-Maideh, 5:89; el-Muxhadele, 58:2-4).

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të skllëvërve që ekzistonin, Profeti Muhammed a.s. i ka urdhëruar muslimanët të jenë të ndjeshëm ndaj kësaj çështjeje dhe u ka thënë:

"Skllëvërit tuaj janë vëllezërit tuaj. Ushqejini ata me atë që hani vetë dhe visheni ata me atë që visheni vetë. Mos u ngarkoni atyre punë të rënda; dhe nëse i ngarkoni, atëherë ndihmojuni." (Buhariu, "el-Iman", 22; Muslimi, "el-Ejman", 40)

3. E drejta për mbrojtjen e nderit dhe të moralit

Nderi dhe morali i individëve janë të shenjtë. Mbrojtja e këtyre është një e drejtë themelore dhe Islami i urdhëron muslimanët që ta respektojnë nderin, moralin dhe dinjitetin e njëritjetrit. Profeti Muhammed a.s. ka thënë: *"Gjaku (jeta), nderi dhe pasuria e çdo muslimani janë të ndaluara për një tjetër musliman. Devotshmëria (takva-*

ja) është këtu (në zemër). Të shohësh me përbuzje një vëlla musliman është mjaft për t'u ngarkuar me një mëkat." (Buhariu, "Medhalim", 3). Në fjalimin e tij të lamtumirës, Profeti Muhammed a.s. dha këshilla të rëndësishme për mbrojtjen e nderit dhe të moralit, duke theksuar:

"O njerëz! Siç janë të shenjta dhe të bekuara për ju këto ditë, ky muaj dhe ky qyteti i juaj, ashtu janë të shenjta dhe të paprekshme edhe jeta, pasuria dhe nderi juaj. Ato janë të mbrojtura (të garantuara) nga çdo lloj sulmi." (Texh-ridu's-Sarih, VI, 334).

4. Prona dhe e drejta për mbrojtjen e pronës

Si individ dhe pjesë e shoqërisë, njeriu ka të drejtë dhe kompetencë të punojë e të përpiqet që në mënyrë të lirë të fitojë pasuri e pronë, ta grumbullojë dhe ta zhvillojë atë, ose edhe ta trashëgojë nga ndokush, duke respektuar gjithnjë

të drejtat e të tjerëve dhe duke qëndruar brenda kufijve të së ligjshmes. Po ashtu, ai ka të drejtë ta përdorë atë pronë sipas dëshirës së tij, duke qëndruar brenda kuadrit të ligjshëm dhe duke përmbushur detyrimet që pasuria i sjell me vete (siç është dhënia e zeqatit, etj.).



E drejta e individit është nën garancinë e ligjit. Askush nuk ka të drejtë ta prekë pronën e tjetrit ose t'ia marrë atë nga dora. Sepse cenimi i pasurisë së tjetrit është një sulm ndaj përpjekjeve dhe mundit të tij. Në fenë tonë, puna dhe përpjekja janë vlera të çmuara.

Për këtë arsye, feja jonë e ndalon shkeljen e të drejtave, vjedhjen, mashtrimin, grabitjen dhe plaçkitjen, dhe ka njoftuar se prona e fituar në këto mënyra nuk është *hallall* (e lejueshme). Allahu i Lartësuar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"O ju që besoni, mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit padrejtësisht, përveçse përmes tregtisë me pëlqim reciprok! Dhe, mos e mbytni veten tuaj! Me të vërtetë, Allahu është mëshirues ndaj jush." (en-Nisa, 4:29)

Besimtari, duke pasur parasysh faktin se një ditë do të japë llogari përpara Allahut xh.sh., nuk e zgjat dorën e tij padrejtësisht mbi pronën e tjetrit. Ai nuk i shkel kufijtë e fqinjëve të tij te ara, te vreshtat apo te kopshti. Ashtu siç ka thënë Profeti ynë Muhammedi a.s.:

"Kushdo që padrejtësisht merr diçka që i përket tjetrit, në Ditën e Gjykimit do të fundoset në shtatë shtresa të tokës së

bashku me atë që e ka marrë padrejtësisht." (Buhariu, "Medhalim", 13; Muslimi, "Musakat", 30)

Ashtu siç është mëkat të marrësh padrejtësisht diçka nga prona apo toka e një individi, po ashtu është mëkat të marrësh diçka nga prona apo toka publike, shoqërore, shtetërore. Sepse kjo i takon gjithë popullit dhe secili qytetar ka të drejtë mbi të.

5. E drejta për mbrojtje nga tortura

Gjatë gjithë historisë, tortura dhe përdorimi i forcës brutale kanë ekzistuar në çdo gjeografi ku ka jetuar njeriu. Vazhdimi i torturës akoma dhe në disa shoqëri të ditëve tona, përbën një problem serioz njerëzor. Konceptet dhe qëndrimet që i japin vlerë njeriut e kundërshtojnë çdo formë të torturës dhe luftojnë kundër atyre që e mbështesin atë. Tortura tashmë konsiderohet krim ndërkombëtar kundër njerëzimit. Kjo qasje teorikisht ka zënë

vend në shumë marrëveshje dhe deklarata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Tortura është një presion dhe shtypje që zbatohet me anë të metodave fizike ose psikologjike, duke shkaktuar dhimbje, për të arritur një qëllim të caktuar. Ajo është një praktikë që nuk përputhet me dinjitetin njerëzor dhe që e poshtëron njeriun.

Feja islame, që prej shekujsh e ka ndaluar çdo lloj torture, pavarësisht arsyes.

Siç thuhet në një hadith kudsij, Allahu i Lartësuar ka thënë: "*Mos i torturoni robërit e Mi!*" (Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, IV, 172-173). Gjithashtu, në burime të ndryshme përmendet se i Dërguari i Allahut u ka dhënë urdhra komandantëve të tij gjatë kohës së luftës, që të respektojnë marrëveshjet, të mos bëjnë tortura, të mos u presin gjymtyrët ose organet njerëzve dhe të mos vriten fëmijët. (Shih: Muslimi,

"Xhihad", 3; Ibn Maxhe, "Xhihad", 38; Tirmidhiu, "Sijer", 48; Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, 1, 300).

Përveç kësaj, Profeti i dashur ka ndaluar jo vetëm torturimin dhe shkaktimin e vuajtjeve ndaj njerëzve, por edhe ndaj kafshëve, duke e ndaluar rrahjen e tyre, lënien pa ushqim dhe pa ujë, dhe ka thënë se ata që veprojnë kështu do të ndëshkohen. (Buhariu, "Dhebaih", 25, "Enbija", 54; Muslimi, "Selam", 151-152, "Birr", 133-134; Nesaiu, "Dahaja", 42).

6. E drejta për mbrojtjen e privatësisë

Ndër të drejtat themelore të njeriut, mbrojtja e privatësisë ka një rëndësi të veçantë. Sidomos në ditët e sotme, si rezultat i përhapjes së mjeteve të komunikimit masiv, parimi i fshehtësisë së jetës private shpeshherë shkelet. Në fenë tonë ekzistojnë shumë parime themelore që e rregullojnë privatësi-

në. Nëse do t'i përmblihdhnim shkur-
timisht këto parime, ato mund të
renditeshin kështu:

**a. Ndalimi i kërimit të gabimeve
ose gjërave të fshehta (*texhessus*)
dhe e përhapjes së çështjeve private
për publikun**

Texhessusi nënkupton kërkimin ose
hetimin e anës së fshehtë ose situatave
private të dikujt. Zakonisht përdoret
në kuptimin e kërimit të gjendjeve të
fshehta dhe të turpshme. Në këtë drej-
tim, *texhessusi* nënkupton kërkimin
dhe përpjekjen për të zbuluar gjendjet
e fshehta të një personi (sidomos të
metat e tij), të cilat të tjerët nuk i dinë
dhe që personi dëshiron t'i mbajë të
fshehta për vete. Zbulimi i tyre atij
mund t'i sjellë dëm material ose shpir-
tëror, ose thjesht janë gjëra që ai
dëshiron të mbeten private. Për shem-
bull, përpjekja për të mësuar llogaritë
bankare të njerëzve, fjalëkalimet e kar-
tave të kreditit, marrëdhëniet e tyre
private me bashkëshortet, përgjimi i

bisedave të fshehta, përpjekja për të hyrë në vende të padëshiruara, leximi i mesazheve telefonike, faksit apo letrave të personave të tjerë e kështu me radhë, janë shkelje të të drejtave të njeriut. Profeti ynë Muhammedi a.s. e ka theksuar rëndësinë e kujdesit ndaj kësaj çështjeje duke thënë:

"Kushdo që shikon në shkrimin e vëllait të tij pa lejen e tij, është sikur të ketë shikuar në zjarrin (e Xhehennemit)." (Ebu Davudi, "Dua", 23)

Islami ndalon hetimin e të metave të njerëzve (*texhessus*), sepse përbën ndërhyrje në jetën private dhe i shkakton shqetësim dhe lëndim personit tjetër. Kur'ani urdhëron: *"Mos hulumtoni të metat e njëri-tjetrit!"* (el-Huxhurat, 49:12) Në vend të kësaj, falja e gabimeve dhe e të metave të njerëzve përmendet si një veprim që e çon njeriun drejt dashurisë së Allahut xh.sh. (Alu Imran, 3:134)

Profeti Muhammed a.s. ka thënë gjithashtu: *"Kushdo që mbulon një të metë të një muslimani, Allahu do t'ia mbulojë të metat atij në Ditën e Gjykimit."* (Buhariu, "Medhalim", 3; Muslimi, "Birr", 58, 72) Me këtë ai ka dashur të tregojë shpërblimin nga ana e Zotit për njeriun i cili i mbulon, i fsheh dhe nuk i publikon të fshehtat, të metat dhe turpet e të tjerëve.



Profeti ynë Muhammedi a.s., në një hadith tjetër, i ka përshkruar ata që kërkojnë të zbulojnë të fshehtat e njerëzve, si persona që e kanë pranuar besi-

min (*imanin*) me gojë, por që besimi nuk ka depërtuar në zemrat e tyre, dhe ka thënë:

"O ju që keni besuar me gjuhën tuaj, por ende nuk e keni sjellë besimin në zemrat tuaja! Mos i përgojoni muslimanët pas shpine dhe mos u përpiqni t'i zbuloni anët e tyre të fshehta. Kushdo që e bën këtë, Allahu do t'ia bëjë të njëjtën gjë dhe do ta poshtërojë në Ditën e Gjykimit." (Muslimi, Birr, 32)

Sidomos në ditët e sotme, është një realitet që sekretet familjare po zbulohen në media dhe çështjet që do të duhej të mbeteshin të fshehta po bëhen publike. Ndonjëherë, situata private që njerëzit mezi mund të përballojnë t'i dëgjojnë nga një person i vetëm, po diskutohen përpara mijëra ose miliona njerëzve. Kjo është një shkelje shumë e rëndë e të drejtave të njeriut. Në një hadith, ku Profeti ynë Muhammedi a.s. i qorton ashpër ata që ndodhen në këto situata, thuhet:

"Pa dyshim, në Ditën e Gjykimit, personi më i keq në sytë e Allahut do të jetë ai që, pasi të ketë qenë i afërt intimisht me bashkëshorten e tij, i zbulon sekretet e saj." (Muslimi, "Nikah", 123; Ebu Davudi, "Edeb", 37)

b. Paprekshmëria e banesës

Paprekshmëria e banesës nënkupton se askush nuk mund të hyjë në një shtëpi të huaj pa leje, nuk mund të kryejë kontrollë dhe nuk mund t'i sekuestrojë gjërat brenda asaj shtëpie. Sipas kësaj, askush nuk mund të hyjë në shtëpinë e dikujt pa lejen e pronarit dhe nuk mund të kryejë asnjë veprim atje, për çfarëdo qëllimi qoftë. E drejta e quajtur "paprekshmëria e banesës" është njohur që nga kohët e lashta.

Islami ka marrë disa masa për të siguruar mbrojtjen e kësaj të drejte. Disa nga masat kryesore janë:

1. Urdhri për të hyrë në shtëpi nga dyert e tyre

Lidhur me këtë çështje, në Kur'an thuhet:

"...Sjellje e mirë nuk është të hyni në shtëpi nga pjesa e pasme e tyre. Sjellja e mirë është të kesh devotshmëri (të ruhesh nga shkelja e urdhrave të Allahut). Hyni në shtëpi nga dyert e tyre dhe ruhuni nga kundërshtimi i Allahut, që të mund të shpëtoni." (el-Bekara, 2:189)

Ky ajet ndalon një nga zakonet e këqija të periudhës para Islamit (*xhahilijjetit*), kur njerëzit shkelnin paprekshmërinë e banesës duke hyrë në të nga vende të tjera përveç derës.


2. Ndalohet hyrja në shtëpi pa leje

Një nga parimet më të rëndësishme për mbrojtjen e privatësisë është që askush nuk duhet të hyjë në shtëpi ose në pronë private të huaj pa lejen e pronarit. Me të vërtetë, "jeta e shtëpisë"

nuk është gjithmonë e përshtatshme për t'u parë nga të tjerët. Në ajetet 58-59 të sures en-Nur në Kur'an, theksohet se është e ndaluar të hyhet pa leje në dhomat e njerëzve, veçanërisht gjatë orëve të pushimit, kur ata janë në dhomat e tyre. Kjo sepse njerëzit mund të ndodhen në forma dhe gjendje që nuk janë të përshtatshme për t'u parë nga të tjerët. Ashtu siç na ka sqaruar Profeti ynë Muhammedi a.s. duke thënë: "*Marrja e lejes është për të mbrojtur sytë* (pra, për të mos parë gjërat që duhen mbajtur private)." (Buhariu, "Isti'dhan", 11; Muslimi, "Edeb", 41)

Siç mund të vihet re, privatësia e jetës private zakonisht shkelet kur njerëzit hyjnë në shtëpi të huaja pa leje dhe pa paralajmërim. Për këtë arsye, disa dijetarë islamë kanë thënë se të hysh në shtëpinë e dikujt tjetër pa leje nuk është asgjë tjetër veçse një shkelje e pronës së dikujt, sikur të përdorësh pasurinë e dikujt tjetër pa leje. (Shih: Elma-

lilı Hamdi Yazır, *Hak Dini Kur'an Di-li*,
IV, 3497)



Ky parim shprehet kështu në Kur'an:

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju, në mënyrë që merrni mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’ju jepet leje, e nëse ju thuhet të ktheheni, atëherë kthehuni

prapë. Kjo është më e ndershme për ju. Allahu di çdo gjë që veproni ju." (En-Nur, 24:27-28)

Në një hadith tjetër, duke iu referuar mënyrës së kërkimit të lejes, Profeti Muhammed a.s. ka thënë: *"Trokitni tri herë në derë. Nëse ju jepet leje, hyni; përndryshe, kthehuni!"* (Tirmidhiu, "Is-ti'dhan", 3; Muslimi, "Edeb", 33-37)

Një ngjarje që i ka ndodhur Omerit r.a. është mjaft interesante. Thuhet se një natë, ndërsa Omeri r.a., si halif që ishte, po patrullonte Medinën, dëgjoji një njeri duke kënduar brenda një shtëpie. Ai kaloi mbi mur dhe hyri në shtëpi. Kur hyri brenda, aty pa një burrë me një grua të huaj dhe pije alkoolike pranë tyre. Me ashpërsi iu drejtua burrit: "O armik i Allahut! A mendon se do të bësh mëkat dhe Allahu do të të fshehtë?" Njeriu iu përgjigj: "Mos u nxito, o udhëheqësi i besimtarëve! Unë kam bërë një mëkat, por ti ke kryer tri mëkate. Allahu thotë: 'Mos kërkoni të zbuloni të metat dhe gjendjet e fshehta të të

tjerëve (texhessus)!' (el-Huxhurat, 49:12), ndërkaq ti e ke shkelur këtë urdhër. Allahu thotë: *'Hyni në shtëpi nga dyert e tyre!'* (el-Bekare, 2:189), por ti hyre duke kapërcyer murin. Përsëri Allahu thotë: *'O ju që keni besuar! Mos hyni në shtëpi të tjera përveç tuajave pa marrë leje dhe pa i përshëndetur banorët brenda!'* (en-Nur, 24:27), por ti hyre në shtëpinë time pa leje." Pas kësaj, hazreti Omeri i tha: "Nëse të fal ty, a do të më falësh edhe ti mua?" Njeriu iu përgjigj: "Po". Dhe Omeri u largua. (Yazır, *po aty*, VI, 4473-4474)

3. Ndalohet të shikosh pa leje brenda shtëpive

Ashtu siç është e ndaluar të hyhet në shtëpi të huaj pa leje, gjithashtu është e ndaluar të shikosh, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjetesh qoftë, brenda shtëpisë pa lejen e pronarit. Profeti ynë Muhammedi a.s. ka thënë: *"Nuk është e lejuar (hallall) për askënd të shi-*

kojë brenda shtëpisë së dikujt pa leje." (Tirmidhiu, "Salat", 148; Ebu Davudi, "Taharet", 43) – duke deklaruar se këto veprime janë të ndaluara.

c. Ndalimi i përgojimit (*gibetit*)

Përgojimi është një nga sjelljet e këqija që shkelin privatësinë e jetës personale. Siç dihet, përgojimi nënkupton të flasësh për një person, kur ai nuk është i pranishëm, gjëra të tilla që nuk do t'i flisje në prani të tij. Përgojimi shkatërron lidhjet e dashurisë, të respektit dhe të bashkëpunimit midis njerëzve dhe shkakton mëri, urrejtje dhe armiqësi në shoqëri. Me përgojimin (*gibetin*), zbulohen gjërat që një person nuk dëshiron t'i dinë të tjerët dhe si rezultat, cenohet privatësia e jetës personale të tij.

Përgojimi është ndaluar në mënyrë të prerë nga feja jonë dhe është krahasuar me ngrënien e mishit të një njeriu të vdekur, për të tërhequr vëmendjen

për neverinë e tij. Ajeti lidhur me këtë është:

"... Dhe mos përgojoni njëri-tjetrin! A mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin." (el-Huxhurat, 49 :12)

d. Ndalimi i përhapjes së fjalëve (thashethemet)

Thashethemet ose bartja e fjalëve që dikush ka dëgjuar nga një person te një tjetër, është një nga veset e këqija që çon në prishjen e marrëdhënieve mes njerëzve dhe në prishjen e paqes në shoqëri.

Bartja e fjalëve shpesh është një mënyrë për të shpërndarë informacionin që lidhet me jetën private të njerëzve. Informacionet që lidhen me jetën private përhapen me anë të thashethemeve. Për këtë arsye, Kur'ani fisnik

kërkon që të mos merren parasysh fjalët e një thashethemexhiu (el-Kalem, 68:11). Ndërsa Profeti ynë Muhammedi a.s., duke treguar për gjendjen e këtyre personave me dobësi morale në botën tjetër, ka thënë:

"Ai që sjell fjalë për të përçarë njerëzit, nuk do të hyjë në Xhenet." (Muslimi, "Iman", 168)

Rrethanat kufizuese të privatësisë së jetës personale

Në disa raste, mund të vendosen kufizime mbi privatësinë e jetës personale. Këto raste zakonisht mbështeten ose në ndonjë domosdoshmëri, ose në ndonjë veprim gjyqësor të kryer brenda rregullave të caktuara. Në këto raste, nuk konsiderohet se është shkelur privatësia e jetës personale.

Këto raste mund t'i radhisim si më poshtë:

1 - Kur një person, që është në rrezik jete, kërkon ndihmë, ose në rastet e fatkeqësive natyrore si zjarri apo përmbytja, mund të hyhet pa leje në shtëpinë e tyre për t'i shpëtuar ata që janë brenda. E njëjta gjë vlen edhe në rast të vjedhjeve ose të sulmeve të armikut.

2 - Brenda rregullave të caktuara, për të kryer një veprim gjyqësor, mund të hyhet në shtëpinë e një personi dhe të bëhen kontrole apo veprime të tjera ligjore. Në këto raste, nuk merret parasysh nëse pronari jep apo nuk jep leje. Sidoqoftë, duke marrë parasysh intimitetin e familjes, është e nevojshme të bëhet lajmërimi para hyrjes në shtëpi.

3 - Ata që, për shkak të profesionit të tyre (si avokatë, mjekë, etj.), kanë qasje në jetën private të të tjerëve, mund të marrin informacione private vetëm aq sa është e nevojshme. Megjithatë, ata nuk guxojnë t'i zbulojnë këto informacione, përveç rasteve kur është absolutisht e domosdoshme.

7. E drejta për migrim, udhëtim dhe vendbanim

Personat që i janë nënshtruar padrejtësisë dhe shtypjes në forma të ndryshme kanë të drejtën më natyrale për të migruar drejt vendeve ku mund të ndihen të sigurt. Edhe nëse nuk përballen me një situatë të tillë, ata kanë të drejtën të udhëtojnë dhe të vendosen kudo që dëshirojnë, në çdo kohë. Në disa ajete që mund t'i ndërlidhim me lirinë e udhëtimit, thuhet kështu:

"A nuk kanë udhëtuar ata nëpër tokë dhe të shohin se si ka qenë përfundimi i atyre që ishin para tyre? ..." (Jusuf, 12 :109)

"Ai është që juve tokën jua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm tek Ai do të ktheheni." (el-Mulk, 67 :15)



Pejgamberi ynë a.s. gjithashtu, në një hadith të tijin, lidhur me udhëtimin ka thënë: "*Udhëtoni, do të gjeni shëndet.*" (Ahmed bin Hanbeli, *Musned*, II, 380).

8. E drejta për lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes

Kur përmenden të drejtat e njeriut, mendja shkon menjëherë te liritë që njerëzit duhet t'i kenë. Një nga këto liri më të rëndësishme, e cila sot përmendet shpesh dhe diskutohet nga këndvështrime të ndryshme, është liria e fesë dhe e ndërgjegjes.

Liria e fesë dhe e ndërgjegjes nënkupton që njerëzit lirisht të mund ta zgjedhin fenë që dëshirojnë, të jetojnë pa ndërhyrje dhe pa kufizime sipas rregullave të fesë së zgjedhur, të marrin dhe të japin mësimë mbi atë fe, si dhe t'ua sqarojnë dhe rekomandojnë atë të tjerëve.

Besimi, para së gjithash, është çështje zemre dhe pranimi personal. Në Islam, njerëzit kanë lirinë të besojnë ose të mos besojnë. Siç thuhet në ajetin: *"E ti thuaj: 'E vërteta është nga Zoti juaj. Prandaj, kush të dojë le të besojë, e kush të dojë le të mohojë...'"* (el-Kehf, 18:29).

Çdokush mund të besojë si të dëshirojë. Nuk mund të ndërhyhet në vullnetin e njerëzve në këtë pikë. Njerëzit kanë lirinë që, në përputhje me vullnetin e tyre, të besojnë ose të mos besojnë. Megjithatë, Allahu i Lartësuar, duke i dhënë njeriut mendjen si një nga dhuntitë më të mëdha dhe duke e bërë atë më të lartë se krijesat e tjera, ka deklaruar se e ka krijuar njeriun për ta

adhuruar Atë (edh-Dharijat, 51:56). Prandaj, qëllimi kryesor i krijimit të njeriut duhet të jetë zgjedhja me vullnet të lirë e rrugës së drejtë (Islamit). Allahu xh.sh. nuk e ka lënë njeriun të vetëm në këtë udhëtim, por e ka ndihmuar atë me profetët e Tij. Sepse, megjithëse njeriu ka aftësinë të dallojë të drejtën nga e gabuara me anë të mendjes, ai ka përfituar gjithashtu edhe nga mësimet dhe udhëheqja e profetëve.

Në fe nuk ka detyrim, por ka përçim ose përcjellje (*teblig*) të fesë. Të gjithë pejgamberët e kanë pasur për detyrë që ta përçojnë dhe ta shpjegojnë fenë. Kur pejgamberët, të cilët janë anëtarë të përzgjedhur dhe shembullorë të njerëzimit, e kryenin këtë detyrë, ata nuk përdornin detyrim, presion ose kërcënime, por mbizotëronte shembulli personal, dëgjimi, bindja, zgjidhja e problemeve, këshillimi, përvulësia dhe fitimi i zemrave me dëshirë. Madje, edhe ndaj armiqve të mëdhenj, të njo-

hur për mizorinë dhe mosbesimin e tyre, sugjerohej përdorimi i fjalëve të buta kur i ftonin në rrugën e Allahut xh. sh. Për shembull, ajeti: *"Shkoni ju të dy (o Musa dhe Harun) te Faraoni, sepse ai vërtet e ka tepruar. Flisni me të fjalë të buta, ndoshta do të mendohet ose do të frikësohet."* (Ta Ha, 20:43-44), është një shembull i bukur për këtë situatë.

Kur themi se në fe nuk ka detyrim, kjo nënkupton që nuk është e drejtë t'i detyrosh njerëzit të pranojnë një besim – qoftë edhe Islamin – me forcë ose t'i bësh të heqin dorë nga ajo që besojnë, dhe në fakt, kjo edhe është e pamundur. Që profetët kanë vetëm detyrën e përçimit të fesë, është shprehja më e mirë e kësaj. Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë:

"(O Muhamed), sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë ata që janë mbi tokë do t'i kishin besuar. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?" (Junus, 10:99)

Në shumë ajete thuhet qartë se edhe detyra fetare e Muhammedit a.s. ishte vetëm përçimi i fesë dhe se ai ishte thjesht një "përgëzues dhe paralajmërues", pa të drejtë të ushtronte presion apo forcë mbi njerëzit (shih Junus, 10:108; el-Isra, 17:105). Ndërsa theksohet se ai nuk ishte një imponues, porse vetëm një këshillues (el-Gashi-jeh, 88:21-22), metoda e tij për thirrjen në fe është përshkruar kështu:

"(O Muhamed!) Thirri njerëzit në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë, dhe debato me ta në mënyrën më të bukur. Me të vërtetë, Zoti yt e di më mirë se kush është larguar nga rruga e Tij dhe kush është në rrugën e drejtë." (en-Nahl, 16:125)

Fakti që në Islam nuk lejohet që një person ta përçojë fenë e tij me presion dhe forcë, shprehet në ajetin: *"Nuk ka detyrim në fe, sepse e vërteta është dalluar qartë nga e pavërteta..."* (el-Bekara, 2:256).

Qortimi i atyre që përpiqeshin t'i detyronin fëmijët, të cilët i përkisnin një feje tjetër, për ta pranuar Islamin (Ebu Davudi, "Xhihad", 126), si dhe lejimi nga ana e Pejgamberit a.s. që njerëzit e feve të tjera të kryenin adhurimin e tyre edhe në xhaminë e muslimanëve, na ndihmon ta kuptojmë përmasën e lirisë së besimit në Islam. Në qytetërimin islam, i cili i ka vazhduar praktikat e Pejgamberit a.s. në këtë pikë, fetë dhe kulturat e ndryshme kanë vazhduar të ekzistojnë pa asnjë vështirësi. Të drejtat që jo-muslimanët i gëzonin në Perandorinë Osmane, janë një shembull i shkëlqyer për këtë.

Megjithatë, në Islam është gjithashtu detyrë t'u shpjegohet njerëzve me besime të gabuara ose të kota, me butësi dhe bindje, se besimet e tyre janë të gabuara. Ky komunikim (*teblig*) nuk duhet të perceptohet si ndërhyrje në lirinë e besimit. Sepse në përcëimin e fesë nuk ka vend për presion apo detyrim.

Për më tepër, urdhri për besimtarët muslimanë që të mos i fyejnë vlerat e shenjta të atyre që besojnë ndryshe është një dëshmi e qartë e rëndësisë së lirisë së besimit në Islam. Një ajet që lidhet me këtë çështje thotë:

"Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), përveç Allahut, e (si hakmarrje) ata pastaj ta shajnë Allahun, pa e ditur madhërinë e Tij..." (el-En'am, 6 :108).

9. E drejta e mendimit dhe e shprehjes së lirë

Mendimi dhe e drejta për ta shprehur atë që mendon janë të drejta natyrore të njeriut. Sepse, ajo që e dallon njeriun nga krijesat e tjera është pikërisht kjo cilësi. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishëm në Kur'an i ka urdhëruar vazhdimisht njerëzit që ta përdo rin mendjen e tyre. Në shumë ajete kur'anore përmenden shprehje të tilla si "që të mendojnë", "që të kuptojnë",

"që të dinë", "që të veprojnë me kujdes", "që të marrin mësim". Për shembull, në një ajet thuhet kështu:

"Pa dyshim, në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të ditës, në anijet që lundrojnë në det për dobinë e njerëzve, në shiun që Allahu e zbret nga qielli për t'i dhënë jetë tokës së vdekur, në përhapjen e çdo lloj krijese mbi tokë, në qarkullimin e erërave dhe në retë që janë të nënshtruara mes qiellit dhe tokës, (në të gjitha këto) ka shenja (dëshmi) për një popull që mendon." (el-Bekara, 2:164)

Mund të themi se në historinë e Islamit, veçanërisht në periudhat e hershme, e drejta për të menduar dhe për ta shprehur lirshëm mendimin, ka gjetur një hapësirë të gjerë zbatimi dhe se në të ka mjaft shembuj që mund t'i kontribuojnë sot qytetërimit botëror. Në historinë e Islamit, kur flitet për mendimin, nuk nënkuptohet vetëm mendimi në fushën fetare, por men-

dimi në të gjitha fushat dhe kjo është konsideruar si një vlerë në vete.

Fakti që në historinë e Islamit janë shfaqur shkolla të ndryshme mendimi dhe se këto mendime janë debatuar në mënyrë të civilizuar; që mendimet kundërshtuese janë përballur me mendime të tjera dhe janë shkruar trajtesa kundërshtuese (*reddije*), janë shembujt më të mirë për këtë. Veçanërisht në plan të parë del ekzistenca e drejtimeve besimore (doktrimore) dhe juridike. Siç dihet, në historinë e mendimit islam, institucioni i "ixhtiha-dit" ka një vend të rëndësishëm. Ixhtihadi është përpjekja maksimale e dijetarëve për të nxjerrë norma juridike për çështje për të cilat nuk ka ndonjë gjykim të qartë e të prerë në Kur'an dhe në Sunnet. Prandaj, ixhtihadi është një aktivitet mendor dhe intelektual. Në ixhtihad, mendimet shprehen lirshëm dhe diskutohen.

Fjalët që Profeti Muhammed a.s. i ka thënë lidhur me këtë temë tregojnë

vlerën që ai i ka dhënë lirisë së mendimit. Në një hadith ai thotë: *"Dijetari që bën ixhtihad (përpjekje për të nxjerrë një gjykim) dhe arrin në përfundim të saktë, do të shpërblehet dyfish; ndërsa nëse bën ixhtihad dhe gabon, do të shpërblehet një herë."* (Buhariu, "I'tisam", 21). Me këtë, ai i inkurajon njerëzit të mos tremben nga të menduarit dhe të shprehin mendimet e tyre lirshëm, duke theksuar se idetë e shkëlqyera lindin nga përplasja e mendimeve të ndryshme.

Në një tjetër hadith, ku Pejgamberi a.s. e përmend lirinë e mendimit, thotë: *"Allahu e ndriçoftë atë që i dëgjon fjalët e mia, i mëson përmendsh dhe ua përcjell të tjerëve ashtu siç i ka dëgjuar nga unë! Ka shumë që mbartin dije tek ata që kuptojnë më mirë. Ka shumë që mbajnë dije, por vetë nuk kanë dije të thellë."* (Tirmidhi, "Ilm", 7).

Mendimi dhe shprehja e mendimeve, në fenë tonë, nuk janë vetëm një e drejtë, por edhe një detyrë. Çdo musliman

e ka për detyrë të përpiqet për të larguar njerëzit nga e keqja dhe për t'i drejtuar ata drejt së mirës, dhe kjo arrihet vetëm me anë të shprehjes së mendimeve. Në Kur'an shohim kritikën ndaj hebrenjve për qëndrimet e tyre të gabuara lidhur me këtë çështje, siç thuhet në një ajet:

"Ata nuk përpiqeshin t'i ndalonin njëritjetrit veprat e këqija që bënin. Sa e keqe ishte sjellja e tyre!" (el-Maideh, 5:78).

10. E drejta për arsim dhe edukim

Islami, feja që urdhrin e parë e ka "Lexo!", në ajetin e parë (el-Alek, 96:1-5) dhe që thotë se të diturit dhe të paditurit nuk mund të jenë të barabartë (ez-Zumer, 39:9), është gjithashtu feja e dijes. Prandaj, Profeti i Islamit, që është edhe lajmëtari i kësaj feje, duke vepruar në përputhje me këtë parim, ka qenë udhëheqës në fushën e dijes dhe ka deklaruar se nxënia e dijes është

të një e drejtë për të gjithë, pa dallim gjinie (Ibnu Maxhe, "Mukaddime", 17).

Kur Profeti Muhammed a.s. emigroi në Medinë, një nga veprimet e para që ndërmori ishte ndërtimi i xhamisë së tij (*Mesxhid en-Nebevij*), dhe pjesën e pasme të saj, të quajtur "Suffe", e shndërroi në një qendër arsimore.



Pejgamberi a.s., i cili dëshironte që askush të mos privohej nga e drejta themelore e arsimit dhe edukimit, ka lënë pas vete shumë hadithe që e lartësojnë dijen dhe që e theksojnë rëndësinë e saj, për t'i vetëdijesuar njerëzit dhe për t'i bërë ata zotërues të të drejtave të tyre. Dijetarët muslimanë, hadithet

e Pejgamberit a.s. që kanë të bëjnë me dijen i kanë mbledhur në kapituj të veçantë në veprat e tyre (Për më shumë, mund të shihni kapitujt mbi dijen në librat e haditheve. Po ashtu edhe librin e Jusuf el-Kardaviut, *Pejgamberi a.s. dhe dituria*, Shkup 2017).

Gjatë periudhës së Medinës, Pejgamberi a.s. ndëmoi një mobilizim të gjerë në fushën e arsimimit dhe edukimit dhe bëri përpjekje të mëdha për ta përmirësuar shkallën e leximit dhe shkrimit, duke synuar që Medinën ta bënte një qendër shkencore. Pas Betejës së Bedrit, ai kushtëzoi lirimin e robërve jobesimtarë që dinin të lexonin e shkruanin, duke kërkuar që secili prej tyre t'ua mësonte dhjetë fëmijëve muslimanë shkrimin dhe leximin (Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, I, 246). Ai gjithashtu dërgonte mësues në rajone të ndryshme dhe, në çdo rast, kërkonte që muslimanët të merrnin pjesë në aktivitetet arsimore. Pejgamberi a.s. caktoi një ditë të veçantë për arsimi-

min e grave, duke i dhënë rëndësi të veçantë edukimit dhe ngritjes arsimore e kulturore të tyre, në të njëjtën mënyrë siç bënte me burrat (Buhariu, "Ilm", 35). Ai e dinte se arsimi dhe edukimi është një e drejtë e natyrshme edhe për gratë.

Përskaj të gjitha vërejtjeve kur'anore dhe shembujve të Muhammedit a.s., në shekullin e 21-të, disa qëndrime dhe koncepte të gabuara që i nënvlerësojnë vajzat, vazhdojnë të jenë prezente në shoqëritë muslimane. Nuk duhet harruar se fëmijët, qofshin djem apo vajza, janë burim gëzimi, bekimi dhe qetësie shpirtërore nga Allahu xh.sh. Format e sjelljeve tona ndaj fëmijëve si dhe masën e dhembshurisë dhe dashurisë sonë ndaj tyre nuk duhet ta përcaktojë gjinia e tyre. E drejta e njërit prej tyre nuk është më pak e vlefshme dhe më pak e shenjtë se e tjetrit. Prandaj, privimi i vajzave nga trashëgimia ose nga mundësitë e arsimimit

dhe edukimit të tyre nuk është në përputhje me parimet e fesë sonë.

Profeti Muhammed a.s. i kushtoi aq shumë rëndësi dijes saqë kërkoi nga disa prej shokëve të tij të mësonin gjuhë të tjera përveç arabishtes. Për shembull, Zejd bin Thabitin, njërin nga shkruarit ose regjistruarit e Kur'anit fisnik, ai e urdhëroi ta mësonte hebraishten, të cilën ai edhe e mësoi (Muhammed Hamidullah, *Muhammedi a.s. - jeta dhe vepra*, I, 82).

Islami, gjithashtu, nuk e miraton fshehjen e dijes nga ata që e zotërojnë, duke i obliguar të njëjtët që ta ndajnë atë me të tjerët. Fshehja e dijes e shkurton të drejtën e njerëzve për të mësuar. Pejgamberi a.s. i ka paralajmëruar në një hadith ata që e fshehin dijen, duke thënë: "*Kushdo që e fsheh një gjë që e di kur pyetet, atij Allahu do t'i vërë një kapistër prej zjarri në Ditën e Gjykimit*" (Tirmidhiu, "Ilm", 3).

Gjithashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë se veprat e atyre që nxënë dije dhe lënë pas vetes dije të dobishme, do të vazhdojnë t'u japin shpërblim edhe pas vdekjes. Hadithi lidhur me këtë çështje, thotë: *"Pas vdekjes së njeriut, veprat e tij ndërpriten, përveç tri gjërave: lëmosha e vazhdueshme (si ndërtimi i shkollave, xhamive, burimeve të ujit apo spitaleve), dija e dobishme dhe fëmijët e devotshëm që luten për të"* (Muslimi, "Vasijjeh", 14).

11. E drejta për punë dhe fitim

Puna dhe fitimi janë si të drejta, ashtu edhe përgjegjësi të individëve. Feja jonë kërkon që njerëzit të punojnë dhe të fitojnë për t'i përmbushur nevojat e tyre, dhe nuk e sheh aspak të përshtatshme që ata ta shtrijnë dorën e lypjes apo të bëhen barrë për të tjerët. Në Kur'an thuhet: *"Njeriut nuk i takon gjë tjetër, përveç asaj që ka punuar."* (en-Nexhm, 53:39).

Edhe peygamberi ynë Muhammedi a.s. na ka inkurajuar për punë dhe fitim, dhe, në çdo rast, është shprehur se lypsaria është gjë e papërshtatshme dhe e shëmtuar. Në një hadith që flet për këtë çështje, ai ka thënë: *"Nuk ka asnjë njeri që të ketë ngrënë një kafshatë më të mirë sesa ajo që e ka fituar me duart (punën, djersën) e veta."* (Buhariu, "Buhu", 15).

Puna e njerëzve duhet të shpërblehet (paguhet) dhe të drejtat e tyre nuk duhet të shkelen. Peygamberi ynë a.s., duke e theksuar rëndësinë e punës dhe të pagesës së drejtë, ka thënë: *"Jepjani punëtorit shpërblimin (pagën) e tij para se t'i thahet djersa!"* (Ibnu Maxheh, "Ruhun", 4). Ai gjithashtu ka thënë: *"Ata janë vëllezërit tuaj, dhe Allahu i ka vendosur ata nën përgjegjësinë tuaj. Kush ka nën kujdes një vëlla në fe, le ta ushqejë me atë që ha vetë dhe le ta veshë me atë që vishet vetë. Mos u ngarkoni atyre punë që nuk mund t'i bëjnë, dhe nëse u ngarkoni, atëherë*

ndihmojuni!" (Buhariu, "Itk ", 16). Me këtë, ai i ka mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe ka kërkuar drejtësi për ta...

Punëtorëve duhet t'u jepet një pagë që përputhet me mundin e tyre, paga nuk duhet të vonohet, sigurimet shoqërore duhet të paguhen dhe kushtet e punës duhet të rregullohen në atë mënyrë që të përputhen me dinjitetin njerëzor. Këto janë të drejta që hyjnë brenda kufijve të së drejtës për të punuar dhe për të fituar. Në një hadith lidhur me shpërblimin e punës, Pejgamberi ynë a. s. ka thënë se ata që nuk ua paguajnë pagën punëtorëve të tyre, do të përballen me Allahun xh.sh. në Ditën e Gjykimit (Buhariu, "Ixharah", 10).

Një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës për të punuar dhe për të fituar është respektimi i parimit të meritokracisë në punësim. Dhënia e një pune një personi më pak të kualifikuar kur ka një tjetër më të aftë, apo diskriminimi në bazë të gjinisë, kombësisë, fesë ose drejtimit fetar, përbën

pengesë ndaj së drejtës për të punuar dhe është shkelje e të drejtave. Pejgamberi ynë a.s., duke tërhequr vëmendjen ndaj kësaj çështjeje, ka thënë në një hadith:

"Kushdo që, për shkak të afërsisë, i jep përparësi dhe punëson dikë tjetër ndërsa ka një person më të aftë dhe më të kualifikuar se ai, ky e ka tradhtuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe gjithë muslimanët." (Ibn Haxher, *el-Metalibu'l-alijeh*, II, 233). Përdorimi nga Pejgamberi a. s. i fjalës "tradhti" në këtë kontekst është shumë i rëndësishëm. Punësimi i njerëzve të pakualifikuar nuk është vetëm një shkelje e të drejtave të atyre që janë më të aftë, por është gjithashtu një shkelje e të drejtave të gjithë shoqërisë. Me fjalë të tjera, kjo situatë përfshin jo vetëm shkeljen e të drejtave individuale, por edhe të të drejtave publike.

Me pak fjalë, liria për të punuar dhe për të fituar përfshin një gamë të gjerë çështjesh, duke filluar nga sigurimi i

kushteve të përshtatshme për punë e deri te ofrimi i shanseve të barabarta, nga dhënia e drejtë dhe e ndershme e shpërblimit për punë e deri te kujdesi ndaj meritokracisë në procesin e punësimit.

II – Përdorimi dhe Kufizimi i të Drejtave

Sipas mësimëve islame, nuk ka përdorim absolut të të drejtave. Me fjalë të tjera, është e pashmangshme që të ketë disa kufizime në përdorimin e të drejtave. Para së gjithash, nevoja që të dobëtit të kenë një zë dhe të jenë të rëndësishëm përkrah të fuqishmëve në shoqëri, përbën një pengesë për përdorimin absolut të të drejtave. Në përputhje me këtë, të drejtat duhet të përdoren sipas drejtësisë dhe në përputhje me qëllimet e tyre sociale.

Sipas fesë sonë, e drejta nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet i dhënë nga Krijuesi për ta arritur një qëllim të ligjshëm. Kjo do të thotë se të drejtat mund të përdoren vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligjvënësi. Për shembull, ndalimi që njerëzit të mos hanë pasuri në mënyrë të padrejtë dhe

të paligjshme fetarisht (el-Bakara, 2: 188) është një kufizim i përdorimit absolut të pronës nga individi. Sipas kësaj, një person nuk mund ta përdorë pasurinë e tij për të luajtur kumar ose për ta shpërdoruar atë, pasi kumari dhe shpërdorimi janë sjellje që nuk konsiderohen të ligjshme sipas fesë. Për më tepër, detyrimi për të dhënë zeqat një sasi të caktuar të pasurisë nga lloje të caktuara të pronave është një tjetër kufizim i lirive të individit për ta shpenzuar të gjithë pasurinë e tij për vete.

Po kështu, edhe keqpërdorimi i të drejtave është një arsye e vlefshme për t'i kufizuar ato. Shembulli më i qartë i keqpërdorimit të një të drejte është kur përdorimi i saj dëmton të tjerët. Profeti Muhammed a.s. në lidhje me shkaktimin e dëmit ka thënë: *"Nuk lejohet dëmtimi dhe as hakmarrja për dëmtim!"* (Ibnu Maxheh, "Ahkam", 17; Muvatta, "Akdije", 31).

Ky hadith në përgjithësi ndalon të gjitha veprimet që shkaktojnë dëm. Për shembull, kur përdoret liria e shprehjes, mendimet duhet të shprehen pa i shqetësuar të tjerët, pa krijuar rrethana dhune dhe pa i nxitur njerëzit në kundërvajtje ose në përçarje.

Përmbyllje

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun që t'i shërbejë Atij dhe i ka dhënë një detyrë në këtë botë. Kryerja e kësaj detyre në mënyrën më ideale është e mundur vetëm me garantimin e disa të drejtave për njeriun. Të drejtat që i garantohen njeriut janë për të siguruar që ai ta vazhdojë jetën në mënyrë të lirë dhe të shëndetshme, si shpirtërisht ashtu edhe fizikisht. Sepse nuk mund të pritet që ata që nuk janë të lirë dhe të sigurt, qoftë shpirtërisht apo fizikisht, ta përmbushin denjësisht detyrën e tyre në këtë botë. Të drejtat që i garantohen njeriut për të qenë i sigurt dhe i lirë, sot njihen si të drejta themelore të njeriut.

Megjithëse të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejtat themelore, historia e njerëzimit ka qenë dëshmitare e përvojave të dhimbshme si racizmi,

kolonializmi, diskriminimi dhe luftërat që kanë shkelur këto të drejta, dhe fatkeqësisht, edhe sot jemi dëshmitarë të këtyre shkeljeve. Madje, këto shkelje, sot, kanë marrë përmasa shumë të ndryshme, duke injoruar të drejtat e kafshëve dhe të gjitha qenieve të gjalla, duke nxjerrë në plan të parë marrëdhëniet e ndikimit ekonomik dhe politik si dhe duke i vënë në rrezik të drejtat e brezave të ardhshëm. Për këtë arsye, sot kemi më shumë nevojë për një koncept të të drejtave dhe përgjegjësi-ve që vendos në qendër vlerat njerëzore, që ndan shqetësimet dhe pritjet, që dallimet i sheh si pasuri dhe që ngrihet mbi parimet e paqes, sigurisë, drejtësisë dhe ndershmërisë. Në një botë ku ndodhin kaq shumë shkelje të të drejtave, ne, si përfaqësues të mesazhit profetik që thotë se "çdo mirësi është lëmoshë", kemi një përgjegjësi dhe detyrë më të domosdoshme që vlerat e gjalla të Islamit t'ia prezantojmë gjithë njerëzimit, me qëllim që drejtësia dhe ligji të rrënjosen dhe forcohen në tokë.

Vërtet, njerëzimi që ishte zhytur në padituri, padrejtësi, mizori dhe shumë gjëra negative që e bënë jetën të pakuptimtë, me ardhjen e Islamit gjeti një rilindje të re. Kjo sepse në qendër të këtyre mesazheve hyjnore gjithmonë ka qenë njeriu, respekti ndaj njeriut dhe lumturia e tij. Pa dyshim, filizat e paqes dhe të lumturisë mund të lulëzojnë vetëm në një mjedis ku respektohen të drejtat e njeriut. Respektimi i të drejtave dhe ligjit, dashuria dhe respekti reciprok, vetëdija e të qenit shërbyes i Zotit si dhe virtytet morale janë elementet themelore për gjetur jetë këto filiza.

Pa dyshim, njerëzimi do ta gjejë paqen dhe lumturinë që kërkon vetëm në mesazhet universale të Islamit. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: *“O ju që keni besuar! Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij ju ftojnë drejt gjërave që ju japin jetë, përgjigjuni thirrjes së tyre..!”* (el-Enfal, 8 :24), duke theksuar se mesazhet hyjnore janë plot „jetë“ për njerë-

zit. I dashuri ynë Muhammedi a.s., në hutben e lamtumirës, që është si një deklaratë e të drejtave të njeriut, tha: *“O njerëz! Gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi (dinjiteti) juaj janë të paprekshme dhe të garantuara, derisa të takoheni me Zotin tuaj.”* Me këto fjalë, ai i kumtoi gjithë njerëzimit se jeta, pasuria dhe nderi i njerëzve janë të shenjta dhe të mbrojtura nga çdo lloj sulmi a shkeljeje.



Një botë ku të gjithë njerëzit i gëzojnë të drejtat themelore si jeta, pronësia, feja dhe liria e ndërgjegjes, si dhe kanë qasje në plotësimin e nevojave theme-

lore si arsimi dhe shëndeti, dhe kumund të përfitojnë nga mirësitë materiale të shoqërisë në mënyrë të drejtë, është një pritshmëri e përbashkët e çdo njeriu të arsyeshëm. Sepse një bukë që nuk ndahet me të tjerët, është e pashijshme; një lumturi që nuk ndahet me të tjerët, është gjysmake.

Për ta mbrojtur nderin e vet në mënyrë dinjitoze nga çdo kërcënim dhe privim, për njeriun është e rëndësishme që koncepti i Islamit për tolerancën, solidaritetin dhe dhembshurinë ndaj çdo qenieje, të zhvillohet në një ambient të shëndetshëm dialogu. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për ne, por për lumturinë e mbarë botës.

Në këtë kuptim, njeriu duhet të kujdeset për të drejtat e të tjerëve, njësoj siç kujdeset për të drejtat e veta; ai duhet t'i respektojë të drejtat e kafshëve dhe të bimëve dhe të mos dëmtojë asnjë qenie të gjallë. Muslimani i vërtetë është ai që, prej dorës apo gojës së të

cilit të tjerët janë të sigurt; ai që sjell mirësi, paqe dhe dashuri për të gjithë.

Sa kemi përgjegjësi për ta kuptuar dhe shpjeguar në mënyrë të saktë Islamin, po aq kemi përgjegjësi për t'i dalë zot dhe mbrojtur jetën, dinjitetin dhe lirinë e besimit të njeriut, që është krijesa më e nderuar nga Zoti ynë.

Me udhëzimet e tij të thukta, si: *"Ai që fle i ngopur ndërsa fqinji i tij është i uritur, nuk është prej nesh."* (Hakimi, *el-Mustedrek*, II, 15); *"Nuk keni besuar (plotësisht) derisa t'ia dëshironi vëllait tuaj atë që ia dëshironi vetvetes."* (Buhariu, "Iman", 7; Müslimi, "Iman", 7); dhe *"Çdo veprim që e shqetëson zemrën tuaj është mëkat."* (Muslimi, "Birr", 14-15; Tirmidhiu, "Zuhd", 40), Pejgambëri ynë i dashur përpiquej t'i bënte të ndjeshme balancat e ndërgjegjes sonë dhe të disiplinonte vullnetin tonë. Si pasues të tij, ne padyshim që e kemi për detyrë t'i mbrojmë të drejtat themelore të çdo njeriu pa dallim gjuhe, feje ose race. Në ndërkohë që ne i da-

lim zot njeriut si në aspektin material e shpirtëror, ashtu edhe në kuadër të vlerave që ne na bëjnë njerëz, duhet t'i lutemi Zotit që zëri i ndërgjegjes individuale të shndërrohet në një ndërgjegje të ndieshme ndërkombëtare dhe që në botë të mbretërojë një ndërgjegje më e pastër dhe më e dëlirë.

Me këto ndjenja dhe mendime, shpresojmë që bota, duke i respektuar të drejtat e njeriut brenda kornizave të drejtësisë dhe të ndershmërisë, të bëhet më e lumtur dhe më e denjë për të jetuar në të...